



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 16.07.2025
Numër Protokolli: 4790/2025

A.nr.1158/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtare, me Flakron Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit duke vepruar sipas ankesës më numër A.nr.1158/2025, të datës 18.06.2025, të parashtruar nga ankuesja K.H-K, kundër organit të punësimit; Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 16.07.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës A.nr.1158/2025, të datës 18.06.2025, të parashtruar nga ankuesja K.H-K.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbimin civil, K.H-K (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 18.06.2025 dhe numër protokolli 4128/2025 të regjistruar nën shenjen A.nr.1158/2025, kundër Njoftimit të datës 28.05.2025 për rezultatet përfundimtare, të konkursit me Referencë RN00017252 të datës 20.03.2024 për Grupi Administrimit të Përgjithshëm, për pozitën “Zyrtar i Skemave Pensionale” të shpallur nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën A.nr.1158/2025 të datës 18.06.2025 të parashtruar nga ankuesja në KPMSHCK; Njoftim të datës 28.05.2025; Konkursit të datës 20.03.2025; Njoftimit të datës 28.05.2025 për rezultatet përfundimtare; Parashtresën e ankueses të datës 02.07.2025.

Kolegji i Këshillit, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, ka konstatuar se janë plotësuar parakushtet ligjore që të **përfundoj procedimi administrativ** i filluar me ankesën e ankueses, **sepse:**

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, më datë 20.03.2025 ka shpallë konkursin me numër Reference RN00017252, Grupi Administrimit të Përgjithshëm, për pozitën “Zyrtar i Skemave Pensionale-Profesional 2” në Mitrovicë, ku afati për aplikim ka qenë nga data 21.03.2025 deri më 19.04.2025, ndërsa nga shkresat e lëndës arrihet në konstatimin se edhe ankuesi ka aplikuar në këtë konkurs.

Tutje, nga shkresat e lëndës, respektivisht sipas Njoftimit të rezultateve përfundimtare datës 28.05.2025, të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, rezulton se ankuesja ka arritur të marrë gjithsejtë 79 pikë, ndërsa kandidati i suksesshme më së shumti pikë është A.S me gjithsejtë 96.8 pike.

Ankuesja, me datë 02.07.2026 përmes e-mailit zyrtar ankesa.kpmshck@rks-gov.net, ka përcjellë parashtrësë juridike, përmes së cilës deklarohet se e njëjta është tërhequr nga ankesa e tij e parashtruar përmes e-maili me datë 18.06.2025 kundër konkursit me numër Reference RN00017252, Grupi Administrimit të Përgjithshëm, për pozitën “Zyrtar i Skemave Pensionale”, të shpallur nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, me arsyetimin se nuk ka interes juridik të qëndrojë prapa ankesës së parashtruar, ndërsa parashtesa e së njëjtës e datës 02.07.2025 në Këshill është protokolluar me numër:4455/2025.

Nisur nga rrethanat e paraqitura si më lartë, Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e nenit 103 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *“1. Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë; 2. Procedura administrative e nisur sipas kërkesës, gjithashtu do të përfundohet, kur nga rrethanat rezulton pa asnjë dyshim se pala nuk ka më interes në vazhdimin e saj dhe e ka braktisur atë”* dhe erdhi në përfundimin se ankuesja përmes parashtrësës së datës 02.07.2025 me numër protokolli:4455/2025 është tërhequr nga ankesa e saj e datës 18.06.2025 e parashtruar në Këshill, dhe mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit konstatoi se janë plotësuar parakushtet ligjore që të përfundohet procedimi administrativ si në dispozitivin e këtij vendimi, lidhur me ankesën e ankueses A.nr.1158/2025 të datës 18.06.2025.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe nenit 103 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1158/2025, datë 16/07/2025.

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses K.H-K;
- Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore), si dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.